

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**ALL IT SOLUTIONS SHPK**

Sot me date 25/01/2024, Znj.Orjana Basho, shtetase shqiptare, i lindur 26/07/1981, ne Gjirokastr, Shqiperi, mbajtese e kartes se identitetit me numer personal I15726091L, (me poshte i quajtur Ortaku) themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te quajtur ALL IT SOLUTIONS ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e meposhtme.

I.

THEMELIMI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ALL IT SOLUTIONS Shpk. (me poshte e quajtura "Shoqeria") themelohet ne perputhje me Ligjin nr 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" I ndryshuar.

II.

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte te ndermarre cdo veprim ose aktivitet tregtar te ligjshem per zhvillimin e te cilave nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te thernelohet dhe regjistrohet sipas legjislacionit shqiptar indryshuar rast pas rasti por pa u kufizuar ne:

- Aktivitetete te lidhura me Teknologjine e Informacionit (IT);
- Aktivitetete te lidhura me (ICT) Infrastruktura Teknologji Informacioni;
- Aktiviteti i rrjeteve te komunikimit elektronik dhe sherbimeve.

Nëse ndonjë nga këto aktivitete kërkon leje të posaçme nga autoriteti shtetëror kompetent, Shoqëria do të kryejë një veprimtari të tillë pas marrjes së lejes ligjore të kërkuar, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore të nevojshme.

III.


SELIA

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Rr. Ismail Qemali Nr. 29/1 Ap.3 Tirane, Albania.

Shoqeria mund te hape dhe mbaje dege, zyra mund të hapë dhe mbajë degë, zyra dhe / ose të kryejë veprimtari biznesi në vende të tjera, qoftë brenda ose jashte territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të administratorit/ve të kompanisë.

IV.

KOHEZGJATJA



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhc kohore te pacaktuar.

V.

ORTAKU DHE KAPITALI FILLESTAR

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte i perbere nga nje kuote, me vlere 100 leke (*njeqind leke*) ne pronesi te plote te

- *Znj.Orjana Basho, shtetase shqiptare, i lindur me 26/07/1981, ne Gjirokaster, Shqiperi dhe mbajtese e kartes se identitetit me numer personal I15726091L, mbajtes i 1(nje) kuote (pjese) me vlere 100 leke, e cila perfaqeson 100% te capital fillestar te shoqerise.*

Kuota jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne cdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne ligjin shqiptar.

Pergjegjesia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

VI.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Pronat, biznesi dhe punet e Shoqerise do te administrohen nga nje ose me shume administratore.

Administratori/et do te veproje dhe perfaqesoje Shoqerine ne perputhje me kompetencat dhe mandatin e dhene nga ligjet e Republikes se Shqiperise dhe Statuti i Shoqerise.

Administratori i pare i Shoqerise do te jete Znj.Orjana Basho, shtetase shqiptare, i lindur me 26/07/1981, ne Gjirokaster, Shqiperi dhe mbajtese e kartes se identitetit me numer personal I15726091L.

VITI USHTRIMOR

Viti Ushtrimor fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 Dhjetor te atij viti.

**ORTAKU**

**ORJANA BASHO**

